

ОГЛЕДАЛО НА ВЛАДАТА

УЧЕСТВОТО НА ЈАВНОСТА ВО
ПРОЦЕСИТЕ НА ПОДГОТОВКА
НА ЗАКОНИ



REPORT VJETOR 2012



Përmbajtja

2 - PËRMBAJTJA

3 - VIZIONI DHE MISIONI
QËLLIMET DHE METODAT

4 - MESAZH NGA UDHËHEQËSIA

Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë

5 - MODERNIZIMI I ARSIMIT

5 - AFTËSIMI I GRAVE TË GODITURA NGA KONFLIKTI

6 - QASJA E ROMËVE DERI TE FONDET

Strategjia e re dhe prioritetet për qasjen e romëve deri te fondet

7 - NDËRMARRJE TË ZHVILLUARA TË VOGLA DHE TË MESME
Udhëheqja me MRFP

Zhvillimi i qëndrueshëm lokal dhe rural

8 - FORUMET NË BASHKËSI

Me mjetet nga forumi do të ndërtohet urë për këmbësorë në Bregallnicë

Sundimi i drejtë, pjesëmarrja dhe politika të orientuara drejt njerëzve

9 - SUNDIMI I DREJTË DHE PJESËMARRJA
Institucionet shtetërore në "Pasqyrë"

Shoqëri civile e rrënjosur dhe dinamike

10 - ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I SHOQËRISË CIVILE

Shkëmbimi i përvojave dhe bashkëpunimi i ri ndërkufitar

Partneritete, marrëdhëniet me opinionin dhe mbështetja

11 - MARRËDHËNIET ME AKTORËT

Marrëdhëniet me opinionin

Mbështetje – MCMS i qëndrueshëm

12 - ORGANIZATA

13 - MENDIM I PAVARUR I REVIZORIT

14 - PERSONELI, ZYRA EKZEKUTIVE

15 - RAPORT FINANCIAR PËR VITIN 2012

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni i MCMS është paqja, harmonia dhe prosperiteti i njerëzve në Maqedoni, Ballkan dhe globalisht.

MCMS e bazon vizionin në parimet universale të shoqërisë civile dhe demokracinë pjesëmarrëse, sundimin e të drejtës, zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm socio-ekonomik, jo dhunë, respekt dhe ndërvarësi dhe diversifikim kulturor.

Misioni i MCMS është të udhëheqë ndryshime me zgjidhje të reja dhe alternative të problemeve shoqërore, të cilat ndikojnë te aktorët tjerë dhe të cilat inkuadrohen në rrjedhat kryesore.

QËLLIMET DHE METODAT

Qëllimet afatgjate të MCMS janë:

- Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë;
- Zhvillimi lokal dhe rural i qëndrueshëm;
- Sundimi i drejtë, pjesëmarrja dhe politika të orientuara nga dhe drejt njerëzve;
- Shoqëri civile e rrënjosur dhe dinamike, që ndikon në politikat publike;
- Diversifikim i pranuar kulturor, ndërvarësi dhe dialog;
- Proces i mbështetur euro-integruar me bashkëpunim të forcuar rajonal;
- MCMS, organizatë e pavarur dhe me kredibilitet, e aftë për partneritete të fuqishme dhe lidhje të bazuara në barazi, në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar;
- MCMS është organizatë atraktive dhe rinovuese që mëson, me rrënjë lokale dhe pikëpamje globale.

MCMS aktivitetet i realizon përmes:

- Avokim (informim, ndërtimi i vetëdijes, edukimi; krijimi dhe ndikimi i politikave; përcjellja dhe kërkimi i përgjegjesisë);
- Mbështetje zhvillimore (kapacitete dhe infrastrukturë);
- Mbështetje sociale-humanitare.

Metodat organizative janë udhëheqja dhe zbatimi.



MCMS

QENDRA MAQEDONASE PËR
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Mesazh nga udhëheqësia

Kriza ekonomike që filloi para disa viteve edhe këtë vit kishte ndikim në zhvillimin ekonomik të vendeve evropiane, duke përfshirë edhe zhvillimin e Maqedonisë.

Në fqinjësi, krahas krizës ekonomike dhe sociale në Greqi, për t'u shënuar është fitimi i Serbisë së statusit kandidat për anëtarësim në Unionin Evropian (UE) dhe fillimi i negociatave të Malit të Zi për anëtarësim në UE. Në Maqedoni, është shënuar rënie e prodhimit industrial, ndërsa indekset e shpenzimeve të jetës dhe të çmimeve me pakicë shënojnë rritje të vogël. Për tu theksuar është fillimi i dialogut para anëtarësimit në nivel të lartë mes Republikës së Maqedonisë dhe Unionit Evropian. Dialogu do të duhej t'i shkurtojë negociatat para qasës kur ato do të fillojnë. Maqedonia e mori raportin më pozitiv nga Komisioni Evropian, i cili vlerësoi se vendi i ka plotësuar kriteret politike dhe rekomandoi hapjen e negociatave për anëtarësim. Për këtë qëllim, Qeveria e miratoi Strategjinë e re për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil (2012-2017) me plan aksionar për zbatim.

Raportet mes partnerëve të koalicionit në Qeveri, VMRO-DPMNE dhe BDI u keqësuan pas ngjarjes në Sllupçan dhe parashtrimin e propozimit për ligjin e ri për 'brantellat'. Për t'u shënuar është greva e mjekëve për shkak të modelit të pagesës sipas punës, bisedat e Qeverisë me gazetarët për dekriminalizim të fyerjes dhe shpifjes, si dhe ndodhitë në dhe para Kuvendit gjatë procedurës për miratimin e buxhetit për vitin 2013.

MCMS në vitin 2012 pati vëllim të përgjithshëm (portfolio) prej 12 projekteve me rreth 49 milionë denarë. Realizimi i portfolios është 80% nga e planifikuara, derisa i buxhetit është 83% nga plani.

Në vitin 2012 MCMS për herë të parë aplikoi metodologji të re për vlerësim të hapjes së institucioneve, që kontribuoi drejt transparencës më të madhe dhe përmirësimit të praktikave të institucioneve për inkuadrimitin e opinionit në proceset e përgatitjes së ligjeve, ndërsa në mënyrë aktive mori pjesë në grupin punues për përgatitjen e Strategjisë së Qeverisë për

bashkëpunim me sektorin civil për vitin 2012-2017.

Edhe këtë vit MCMS vazhdoi me aktivitete hulumtuese. Realizoi tre anketa të cilat kishin të bëjnë me integrimet evropiane dhe rejtingun e partive politike; për perceptimet për rastin Sllupçan dhe ligjin për 'brantellat', si dhe për qëndrimet e qytetarëve për çështje aktuale. Në vitin 2012, MCMS bëri shumë përpjekje për sigurimin e mjeteve financiare nga burime të reja të financimit për periudhën e ardhshme afatmesme. Në vitin 2012 u dorëzuan 31 aplikacione, nga të cilat një e treta u miratuan. Krahas këtyre, u miratua edhe një nga aplikacionet e vjetshme, me çka u kontribua drejt stabilitetit financiar të MCMS gjatë vitit 2012.

Lidhur me organizimin e brendshëm, në pajtim me politikat për ristrukturim social të MCMS, në periudhën e raportimit pesë bashkëpunëtorëve u ndërpre marrëdhënia e punës me MCMS – dy me marrëveshje, ndërsa tre bashkëpunëtorëve me ndërprerjen e marrëveshjes për punë për shkaqe afariste dhe kompensim adekuat social. Në fund të vitit 2012 MCMS angazhoi edhe katër bashkëpunëtorë të ri. Për t'u theksuar është edhe ajo se në vitin 2012 katër bashkëpunëtorë fituan titullin e magjistrit.

Këshilli i MCMS e solli Planin afarist të MCMS 2012-2016. Këtë vit përfundoi mandati katërvjeçar i përbërjes së deritanishme të Këshillit të MCMS. Në mbledhjen e fundit të Këshillit në dhjetor të këtij viti u zgjidh përbërja e re prej shtatë anëtarë të Këshillit të MCMS me mandat prej katër vjet 2012-2016.



Aleksandar Kërzhhalovski
Drejtor i parë ekzekutiv



Dimçe Mitreski
Drejtor ekzekutiv

Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë

MODERNIZIMI I ARSIMIT

Qëllimi është të kontribuohet drejt avancimit të kualitetit të mësimit dhe rritja e pjesëmarrjes në mësim në shkollat qëllimore në projekt.

Gjatë vitit 2012 u rinovuan dy shkolla fillore. Në SHF "Aleksandar Turunxhiev" në f. Kukureçani u bë rikonstruimi i dritareve dhe dyerve, përpunimi i studimit dhe dokumentacioni teknik për rinovimin e sallës sportive dhe pjesës për administratë. Në SHF "Goce Dellçev" në Demir Hisar u rikonstruan të gjitha dritaret dhe dyert.

Të dy shkollat u mbështetën edhe në dy vitet e mëparshme. U rinovuan njejt sanitare, ambientet e bodrumit etj. Me mjetet e reja u siguria zgjidhja gjithëpërfshirëse e problemeve infrastrukturore.

Aktivitetet realizuan tashmë pesë vjet. Mjetet financiare i siguron Sokotab në bashkëpunim me partnerët e vet. Shkollat të cilat janë rinovuar shpesh gjenden në mjedise rurale ku mbisundon prodhimi i duhanit oriental.



Viti shkollor filloi me dritare të reja


AFTËSIMI I GRAVE TË GODITURA NGA KONFLIKTI

Qëllimi i programit është qasja e mbështetur e grave të goditura nga konflikti deri te tregu i punës.

Në nëntor të vitit 2012 filloi zbatimi i programit "Aftësimi i grave të goditura nga konflikti" (OZHP), i financuar nga Unioni Evropian dhe MCMS.

Në periudhën e raportimit u realizuan aktivitetet përgatitëse për identifikimin e grave nga shtatë komuna: Likovë, Tearcë, Zhelinë, Jegunovc, Çair, saraj dhe Mavrova dhe Rostusha. Gjithashtu u filloi edhe me identifikimin e ndërmarrjeve lokale nga rajonet ku janë locuar shtatë komunat, në të cilat do të mundësohet angazhimi i grave.

Programi realizohet në partneritet me tre organizata lokale qytetare, me të cilat u mbajtën disa mbledhje për koordinim për realizimin e programit.



Një nga takimet informative me gratë të mbajtur në Tearcë

Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë

QASJA E ROMËVE DERI TE FONDET

Qëllimi është të forcohen kapacitetet e romëve për aplikim deri te fondet e UE.

Në vitin 2012 u mbështetën përgatitja e 37 projekteve për inkuadrim social të romëve. U mbajtën dy punëtori për përgatitjen e propozim-projekteve për thirrjet për mbështetje financiare shtetërore, për UE, Ambasadën australiane, Kombet e Bashkuara, SDC dhe projektin e USAID për shoqëri civile. Tre nga aplikacionet e parashtruara u miratuan.

MCMS mori pjesë edhe në iniciativat për formimin e rrjetit të kryetarëve të komunave të cilët kontribuojnë në kohezionin social, veçanërisht lidhur me romët.

U përgatit edhe analiza rajonale për shfrytëzimin e fondeve nga Instrumenti para qasjes (IPA) për inkluzion social të romëve.

Strategjia e re dhe prioritetet për qasjen e romëve deri te fondet

Në korrik të vitit 2012 në Veles u mbajt mbledhje rajonale për definimin e orientimeve strategjike "Të bëhet maksimumi me fondet nga UE për romët (MtM)". Në këtë mbledhje morën pjesë 20 përfaqësues të organizatave zbatuese nacionale nga Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Kroacia, si dhe përfaqësues të institucioneve relevante nga këto katër vende, të Institutit Shoqëria e Hapur (ISHH) dhe të Sekretariatit të Dekadës së Romëve.

Pjesëmarrësit i definuan qëllimet strategjike, rezultatet e pritura, aktivitetet dhe treguesit në katër komponentët e MtM.

Në komponentin e parë për vëzhgim dhe avokim u diskutua për mënyrat më të mira për ndikim të programimit të Instrumentit për ndihmë para qasjes (IPA) për avokim më të madh të inkuadrimin social të romëve.

Në komponentin e dytë për ndihmë teknike të organizatave qytetare rome, u nda përvoja e partnerëve nacional nga Maqedonia, MCMS dhe InSOk, të cilët më së gjati e realizojnë këtë komponent. U identifikuan mënyrat për përmirësim të ndihmës teknike dhe zgjerimin e fondeve dhe sektorëve të mundshëm.

Në komponentin e tretë për zhvillim lokal dhe anëtarësim në UE, pjesëmarrësit biseduan për forcimin e kapaciteteve të komunave me popullatë rome për inkuadrimin e nevojave lokale në programimin e IPA, por edhe të buxhetit nacional.

Pjesëmarrësit në komponentin e fundit për bashkëpunim rajonal definuan një set të aktivitetëve të cilat do të realizohen në nivel nacional dhe rajonal për avokim më të mirë të interesave të popullatës rome në katër vendet.

Atmosferë pune në mbledhjen rajonale të iniciativës së MtM



Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë

NDËRMARRJE TË ZHVILLUARA TË VOGLA DHE TË MESME – UDHËHEQJA ME MRFP

MCMS i kryen të gjitha punët udhëheqëse, profesionale dhe administrative për Fondacionin Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrjet (MRFP).

Në periudhën e raportimit, janë paguar huazime në vlerë prej 108.032.767 denarë (1.75 milionë euro) ndaj 791 ndërmarrjeve mikro dhe të vogla. Me këto huazime janë mbështetur 703 vende të përhershme pune të shfrytëzuesit e kredive dhe janë planifikuar 495 vende të reja pune. Pagesa e huazimeve nga ndërmjetësuesit financiar (NF) ndaj MRFP janë realizuar në tërësi.

Gjithsej kreditë e paguara nga fillimi me punë e MRFP nga 31.12.2012 është mbi 2.2 miliardë denarë (36.7 milionë euro) ndaj 10.163 klientëve. Duke iu falënderuar kësaj, për 14 vjet, janë mbështetur gjithsej 16.755 vende të përhershme dhe 3.971 vende të planifikuara pune.

Në vitin 2012 ndërmjetësuesit financiar kanë paguar mbi 108 milionë denarë nga linja kreditore e MRFP. Prej tyre, 92.921.984 denarë ishin për 786 mikro kredi (deri 15.000 euro), 15.110.783 denarë për 5 kredi të vogla (15-100.000 euro).

MRFP, si pjesë e Ekipit nacional të hulumtimit botëror të sipërmarrësish (NT GEM), për herë të tretë e zbatoi hulumtimin më të madh për sipërmarrësi në botë dhe në Maqedoni. Një nga aktivitetet e rregullta, mbështetja e Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë (LOEM) është finalizuar gjatë vitit 2012 me përgatitjen e Planit të ri strategjik të LOEM. MRFP ishte partner lokal i Maqedonia

2025 në organizimin e Samitit investues global, që u mbajt prej 18 deri 21 tetor në Ohër.

Gjatë vitit 2012 në tërësi u realizuan aktivitetet e projektit në kuadër të programit Përgjegjësia shoqërore e ndërmarrjeve (PSHN), e ko-financuar nga Komisioni Evropian, ndërsa janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara në projektin Aktivitetet ekonomike në Kosovë.

Nga fundi i vitit, MRFP filloi me zbatimin e programit të ri me titull: Rruga drejt karrierës – përmirësimi i punësimit të grave nga pakicat etnike në rajonin lindor, të mbështetur nga Ministria e Financave të RM (në kuadër të Instrumentit për ndihmë para anëtarësimit për resurse njerëzore).

MRFP përsëri ishte një nga organizuesit kryesor të manifestimit Sipërmarrës i vitit, qëllim i të cilit është të promovojë sipërmarrës të bizneseve të suksesshme mikro dhe të vogla në vend. Në vitin 2012, MRFP i zgjodhi anëtarët e ri të Këshillit të MRFP, si dhe të Këshillit të kujdestarisë për mandatin e ardhshëm prej katër viteve.

Më shumë detaje për arritjet e MRFP mund të shihni në Progres raportin vjetor dhe financiar të MRFP për vitin 2012 www.mrfp.mk

Nga forumi kushtuar të drejtave të punësuarve



Zhvillimi i qëndrueshëm lokal dhe rural

FORUMET NË BASHKËSI

Qëllimi është të vendosen qasje pjesëmarrëse në bashkësitë.

MCMS realizoi aktivitete në tetë komuna.

Në komunat Kriva Pallankë dhe Makedonski Brod u realizuan projektet e votuara dhe u mbajtën sesionet vijuese. Përfunduan sesionet e forumeve në Çeshinovë- Obleshevë, ndërsa deri në fund të vitit u realizuan edhe projektet e zgjedhura: "mekanizim special për grumbullimin, transportin dhe deponimin e mbeturinave". Në Delleçvë dhe Zhelinë u zbatuan pesë sesione forumi. Qytetarët e Delleçvës e zgjodhën projektin "Urë për këmbësorë mbi lumin Bregallnicë", ndërsa qytetarët e komunës së Zhelinës "Mbindërtimi i SHF 'Pasho Vasa' në fshatin Novosellë". Deri në fund të vitit, në komunën e Aerodromit u realizuan pesë sesione forumi dhe qytetarët e zgjodhën projektin "Rikonstruimi i gardheve të SHF dhe vendosja e video mbikëqyrjes së jashtme, për shkak të sigurisë së nxënësve", derisa në komunat Vasilevë dhe Bosillovë u mbajtën katër sesione forumi.

Me mjetet nga forumi do të ndërtohet urë për këmbësorë në Bregallnicë

Qytetarët e Delleçvës e zgjodhën projektin për të cilin mendonin se është më prioritar për ata, Ura për këmbësorë mbi lumin Bregallnicë. Në sesionin e pestë të forumit, ky projekt fitoi 39 vota dhe do të zbatohet me fond nga programi Forumet në bashkësi.

"Ndjenjë e mrekullueshme është që ne të rinjtë ishim pjesë e një projekti të rëndësishëm, i cili përgatitej gjatë sesioneve të forumit,

ndërsa më i rëndësishëm është edhe fakti se qytetarët vetë e zgjodhën atë që me të vërtetë u nevojitej", tha në fund të sesionit Katerina Antovska.

Kryetari i Komunës së Delleçvës z. Goran Maleshevski qytetarëve të pranishëm ua uroi zgjedhjen e bërë. Qytetarët ia dorëzuan 37 rekomandimet, ndërsa ai u obligua bashkë me administratën komunale se do të bëjnë gjithçka që është në kompetencat e tyre, që t'i realizojnë.

Në listën e rekomandimeve u shtuan edhe katër projekte të cilat morën më pak vota, ndërsa mjetet nga fondi i programit nuk ishin të mjaftueshme që të realizohen: Ndërtimi dhe rregullimi i sipërfaqeve publike; Pastrimi i deponive të egra në qytet dhe rrethinën e tij; Rregullimi i vendeve për piknik dhe turistike, Ura për këmbësorë mbi lumin Bregallnicë dhe Ruajtja e fondit të peshqve përmes ndërtimit të shtigjeve për peshq në I. Bregallnicë.

Qytetarët e Delleçvës u organizuan në grup punues që do ta zbatojë projektin e zgjedhur dhe rekomandimet dhe do t'i informojë qytetarët e Komunës së Delleçvës në sesionin vijues të 6-të të forumit.

Të rinjtë në mënyrë aktive u inkuadruan në diskutimet e sesioneve të forumit dhe dhanë kontribut në zhvillimin e idesë së projektit



Sundimi i drejtë, pjesëmarrja dhe politika të orientuara drejt njerëzve

SUNDIMI I DREJTË DHE PJESËMARRJA

Qëllimi është të rritet përgjegjësia e institucioneve, organizatave qytetare dhe qytetarëve.

MCMS në partneritet me Qendrën Sllovene të Organizatave Joqeveritare (CNVOS) dhe Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN) e zbatoi projektin "Pasqyra e Qeverisë: pjesëmarrja e opinionit në proceset e përgatitjes së ligjeve". U organizuan dy trajnime themelore për inkuadrim aktiv në përgatitjen e ligjeve dhe dy trajnime të avancuara për proceset e krijimit të politikave dhe përgatitjen e ligjeve.

U organizua punëtorja rajonale "Partnerë ose kundërshtarë?: Shkëmbimi i praktikave të mira për përcjelljen e politikave qeveritare dhe proceset në vendet e zgjerimit".

U përgatit edhe ueb faqja www.ogledalonavladata.mk, e cila mes tjerash ka edhe pjesë të veçantë për përcjelljen e inkuadrimin të opinionit dhe organizatave qytetare në procesin e përgatitjes së ligjeve nga ana e organeve të shtetit.

U organizuan tre punëtori për përfaqësuesit e organizatave qytetare për rritjen e pjesëmarrjes së OQ në përgatitjen e ligjeve.

Në bashkëpunim me OSBE u përgatit "Analiza për transparencë në procesin e përgatitjes së ligjeve me fokus të informatës kthyesë të komenteve nga ana e opinionit". Në bazë të gjetjeve nga analiza u përgatit edhe Ciceroni.

Institucionet shtetërore në "Pasqyrë"

Për nevojat e projektit u përshtat metodologjia për vlerësim të asaj sa të hapura janë institucionet qeveritare, të zhvilluar nga ana e CNVOS dhe u vendosën treguesit për matjen e transparencës së organeve të shtetit në Maqedoni. Përcjellja e proceseve të përgatitjes së ligjeve dhe anketimi i institucioneve shtetërore rezultoi me analizë për atë sa janë të hapura institucionet. Analiza i përfshiu propozimet ligjet të shqyrtuara nga ana e Qeverisë në periudhën prej 1 mars deri 31 tetor 2012.

Vlerësimi më i lartë për rrethimin komunikues dhe mbështetës është 4 dhe e morën Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Nga institucionet tjera shtetërore notë më të lartë 5 morën Agjencia për të Rinj dhe Sport. Për hapje në procesin e përgatitjes së propozim ligjeve, më së mirë janë vlerësuar: Propozim-ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për menaxhim me mbeturinat e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Propozim-ligji për mbrojtje shëndetësore e Ministrisë së Shëndetësisë.

Rezultatet nga përcjellja e evglave për inkuadrim të opinionit në përgatitjen e ligjeve (ENER dhe ueb faqet e ministrive) mund të gjenden në: www.ogledalonavladata.mk

Nga trajnimi për aplikimin e metodologjisë për vlerësim të qenit të hapur të ministrive



Shoqëri civile e rrënjosur dhe dinamike

ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I SHOQËRISË CIVILE

Qëllimi është të krijohet rrethinë mundësuese, të mbështetet zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë civile dhe të përmirësohen rezultatet e aktorëve të shoqërisë civile në Maqedoni.

MCMS mori pjesë në përgatitjen e matricës së parë për përcjelljen e rrethinës për zhvillimin e shoqërisë civile. U organizua fokus-grup për lehtësimin tatimor për organizatat qytetare, si dhe u publikua analiza rreth kësaj teme. MCMS në bashkëpunim me ECNL organizoi trajnim dyditor për anëtarët e Komisionit për statusin me interes publik. U organizuan edhe katër ngjarje njëditore informative për rreth 60 organizata qytetare për mundësitë dhe sfidat nga zbatimi i Ligjit për shoqata dhe fondacione, me theks për marrjen me aktivitete ekonomike dhe statusin – organizatë me interes publik.

Vazhduan hulumtimet e opinionit publik në tema për integritet evropian dhe rejtingun e partive politike, si dhe për perceptimet për rastin e Sllupçanit dhe ligjin për "branitellat". Për Gallup Evropa u zbatua anketë për qëndrimet dhe perceptimet e qytetarëve për çështje aktuale.

MCMS facilitoi katër konferenca për Agjencinë për realizimin e të drejtave të bashkësive (ARDB), për të cilin përgatiti edhe propozim program për mbështetje financiare të shoqatave dhe fondacioneve dhe dokumente të zhvilluara shoqëruese. Për gjashtë organizata kosovare, partnerë të Koalicionit Sipërmarrje e Bashkuar u realizuan më shumë punëtori.

Shkëmbimi i përvojave dhe bashkëpunimi i ri ndërkuftar

Deri në fund të marsit 2012 u organizuan punëtori dhe panair për bashkëpunim ndërkuftar. Në Elbasan u mbajt punëtorja e dytë e përbashkët "Krijimi i rrjeteve ndërkuftare": nga teoria në praktikë", në të cilën morën pjesë përfaqësues të 21 organizatave qytetare nga rajoni i Pollogut, Maqedonisë Jugperëndimore, Dibrës dhe Elbasanit. Në punëtori u zgjodhën problemet e përbashkëta prioritare dhe u përpunuan korniza logjike në pesë grupe punuese në fushën e zhvillimit ekonomik, kohezionit social dhe kulturës. Në Dibër u mbajt Forumi i organizatave qytetare nga rajoni ndërkuftar i Maqedonisë dhe Shqipërisë. Morën pjesë 92 organizata qytetare nga të dy shtetet, ndërsa e vizituan më shumë se 800 qytetarë. Përveç pjesës ekspozuese, pjesëmarrësit debatuan për tema aktuale. U mbajtën shtatë diskutime dhe prezantime. Në pjesën socio-kulturore shoqatat e prezantuan trashëgiminë kulturore.

Pjesëmarrësit në projekt shprehën kënaqësi nga aktivitetet në të cilat morën pjesë. Përveç shkathtësive dhe njohurive që i fituan, ata patën mundësi të gjejnë partner për projekte të ardhshme. "Në fillim të projektit nuk njihnim organizatë nga Shqipëria, pastaj u njoftuam, ndërsa tani planifikojmë aktivitete të përbashkëta dhe përrshëndetemi me përfaqime", deklaroi një nga pjesëmarrësit.

Nga hapja solemne e "Forumit ndërkuftar të shoqërisë civile"



Partneritete, marrëdhëniet me opinionin dhe mbështetja

MARRËDHËNIET ME AKTORËT

Bashkëpunimi i MCMS u zhvillua me organizata dhe institucione të vendit, me agjenci anëtare të Këshillit Botëror të Kishave dhe me organizata tjera të jashtme.

MARRËDHËNIET ME OPINIONIN

Gjatë vitit 2012 u publikuan 12 numra të e-buletinit. Raporti vjetor është publikuar në formë elektronike (në CD) në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Ueb faqja vazhdimisht azhurnohet, ndërsa një pjesë e përmbajtjes së saj publikohet edhe në media tjera sociale, duke mundësuar në këtë mënyrë dukshmëri më të madhe të punës së MCMS. Për aktivitetet e MCMS mediat kanë raportuar nëpër 97 artikuj/tekste.

MBËSHTETJE – MCMS I QËNDRUESHËM

Qasja drejt burimeve të financimit

Gjatë vitit 2012 u përgatitën dhe u parashtruan gjithsej 31 aplikacione të reje. Prej tyre, trembëdhjetë u pranuan. Në vitin 2012 u miratua edhe një nga aplikacionet e parashtruara viteve të mëparshme.

Vullnetarizmi

MCMS vazhdoi me praktikën e vet për angazhimin e vullnetarëve. Gjatë vitit 2012 arritën 39 paraqitje për vullnetarizëm. Pas seleksionimit dhe organizimit të pranimit u angazhuan gjithsej 11 vullnetarë në tre periudha gjatë vitit 2012.



<https://www.facebook.com/mcms.mk>



http://0.mk/mcms_linkedin



http://www.scribd.com/mcms_mk



<http://www.youtube.com/mcmsmkic>



https://twitter.com/mcms_mk



<http://www.flickr.com/photos/27413255@N07>

Organizata

Këtë vit përfundoi mandati katërvjeçar i përbërjes së deritanishme të Këshillit të MCMS. Në mbledhjen e fundit të Këshillit të mbajtur në dhjetor 2012 u zgjidh përbërja e re, prej shtatë anëtarë e Këshillit të MCMS, me mandat prej katër vjet për periudhën dhjetor 2012 – dhjetor 2016.

KËSHILLI – Përbërja deri 14 dhjetor 2012

- Ahmet Jasharevski
- Behixhudin Shehapi
- Bekim Imeri
- Biljana Gerasimovska-Kitanovska
- Vladimir Todoroviq
- Gazmend Ajdini
- Dilbera Kamberovska
- Dushica Perishiq
- Dushko Kantarxhiev
- Gjoko Gjorevski
- Gjuner Ismail
- Elena Nikolova
- Zvonko Shavreski
- Illo Trajkovski
- Jagup Selimoski
- Kelmend Zajazi
- Koço Angjushev
- Mihail Cekov
- Pepo Levi
- Rami Qerimi
- Ratko Llazarevski
- Rizvan Sulejmani
- Sllavko Veleovski

KËSHILLI – Përbërja prej 14 dhjetor 2012

- Liljana Allçeva (Habitat)
- Gabriela Micevska (CeProSard)
- Samet Skenderi (InSok)
- Zvonko Shavreski (Polio plus)
- Behixhudin Shehapi (El Hilal)
- Boban Micevski (Kisha Ortodokse Maqedonase)
- Jagup Selimoski (Bashkësia Fetare Islame)
- Bjanka Subotiq (Bashkësia Hebraike)
- Vlladimri Misev (Instituti për Demokraci)
- Rizvan Sulejmani (Instituti për Studime Politike dhe Ndërkulturore)
- Ganka Cvetanova Samoillova (Ohër – Instituti për Strategji Ekonomike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare)
- Sasho Klekovski (propozim i dy anëtarëve të Këshillit drejtues)
- Goran Mihajllovski (Vest)
- Ratko Llazarevski (Nova Makedonija)
- Sllavko Veleovski (Komuna e Mogillës)
- Dushica Perishiq (ZELS)
- Bekim Imeri (Banka Botërore)

KËSHILLI DREJTUES

- Rizvan Sulejmani, kryesues, doktor i shkencave politike, drejtor i Institutit për Studime Politike dhe Ndërkulturore në Shkup
- Koço Angjushev, zëvendës-kryesues, doktor i shkencave teknike
- Biljana Gerasimovska-Kitanovska, doktor i mjekësisë së përgjithshme, magjistër i nefrologjisë, anëtare e ESE – Shkup
- Behixhudin Shehapi, kryetar i El Hilal, Shkup
- Goran Mihajllovski, kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i "Vest"
- Gjoko Gjorgjevski, Kisha Ortodokse Maqedonase
- Jagup Selimoski, Bashkësia Islame në R. Maqedonisë
- Sllavko Veleovski, kryetar i Komunës së Mogillës

Mendimi i pavarur i revizorit

MOORE STEPHENS
SKOPJE

**ИЗВЕШТАЈ НА НЕЗАВИСНИОТ РЕВИЗОР
ДО
СОВЕТОТ НА
МАКЕДОНСКИ ЦЕНТАР ЗА МЕЃУНАРОДНА СОРАБОТКА**

Ние извршивме ревизија на приложените финансиски извештаи на Македонски центар за меѓународна соработка (МЦМС), кои што го вклучуваат Извештајот за финансиска состојба заклучно со 31 декември 2012 година, како и Извештајот за сеопфатна добивка, Извештајот за промени во главнината и Извештајот за парични текови за годината која завршува тогаш и прегледот на значајните сметководствени политики и други објаснувачки белешки.

Одговорност на раководството за финансиските извештаи

Раководството е одговорно за подготвување и објективно презентирање на овие финансиски извештаи во согласност со Меѓународните стандарди за финансиско известување кои се прифатени и објавени во Република Македонија. Оваа одговорност вклучува: обликување, имплементирање и одржување на интерна контрола која што е релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиски извештаи кои што се ослободени од материјално погрешно прикажување, без разлика дали се резултат на измама или грешка, избирање и примена на соодветни сметководствени политики, како и правење на сметководствени проценки кои што се разумни во околностите.

Одговорност на ревизорот

Наша одговорност е да изразиме мислење за овие финансиски извештаи, врз основа на нашата ревизија. Ние ја спроведовме нашата ревизија во согласност со Меѓународните стандарди за ревизија. Тие стандарди бараат да ги почитуваме етичките барања и да ја планираме и извршиме ревизијата за да добиеме разумно уверување за тоа дали финансиските извештаи се ослободени од материјално погрешно прикажување.

Ревизијата вклучува извршување на постапки за прибавување на ревизорски докази за износите и обелоденувањата во финансиските извештаи. Избраните постапки зависат од расудувањето на ревизорот, вклучувајќи ја и проценката на ризиците од материјално погрешно прикажување на финансиските извештаи, без разлика дали е резултат на измама или грешка. Кога ги прави тие проценки на ризикот, ревизорот ја разгледува интерната контрола релевантна за подготвувањето и објективното презентирање на финансиските извештаи на ентитетот за да обликува ревизорски постапки кои што се соодветни во околностите, но не за целта на изразување на мислење за ефективност на интерната контрола на ентитетот. Ревизијата исто така вклучува и оценка на соодветноста на користените сметководствени политики и на разумноста на сметководствените проценки направени од страна на раководството, како и оценка на севкупното презентирање на финансиските извештаи.

Ние веруваме дека ревизорските докази кои што ги имаме прибавено се достатни и соодветни за да обезбедат основа за нашето ревизорско мислење.

Мислење

Според нашето мислење, финансиските извештаи ја презентираат објективно, од сите материјални аспекти, финансиската состојба на Македонски центар за меѓународна соработка заклучно со 31 декември 2012 година, како и неговата финансиска успешност и неговите парични текови за годината која што завршува тогаш во согласност со Меѓународните стандарди за финансиско известување кои се прифатени и објавени во Република Македонија.

Скопје, 30 април 2013 година

Овластен ревизор

Гоце Христов

Управител и Овластен ревизор

Антонио Велјанов



Personeli, zyra ekzekutive

Bordi i drejtorëve

Drejtor i parë ekzekutiv
Aleksandar Kërzhallovski
akr@mcms.mk

Drejtor ekzekutiv
Dimçe Mitreski
dmt@mcms.mk

Grupi i shoqërisë civile

Emina Nuredinoska
enr@mcms.mk

Valentina Çiçeva
vch@mcms.mk

Daniella Stojanova
dst@mcms.mk

Marija Sazdevski
msz@mcms.mk

Simona Ognenovska
sog@mcms.mk

Borjan Gjuzellov
bgz@mcms.mk

Grupi për punësim

Tetjana Llazarevska
tlz@mrfp.mk

Llazar Nedanovski
lnd@mcms.mk

Gligor Mihaillovski
gmh@mrfp.mk

Jasmina Popovska
jpp@mrfp.mk

Fisnik Shabani
fsh@mrfp.mk

Dimitar Smiljanovski
dsm@mrfp.mk

Grupi për informata

Gonce Jakovleska
gjk@mcms.mk

Gramoz Shabani

Boris Ristovski
brs@mcms.mk

Grupi për zhvillim

Goran Jordanoski

Sara Mustafa
sms@mcms.mk

Marrëdhëniet mes bashkësive dhe Ballkan

Dervisha Haxhiq-Rahiq

Grupi i administratës

Millka Bozhinovska-Miova
mmv@mcms.mk

Krenar Kuka
kkk@mcms.mk

Adis Rahiq
arh@mcms.mk

Danillo Mitov
div@mcms.mk

Në fund të vitit 2012 MCMS kishte 22 bashkëpunëtorë, prej të cilëve 16 me marrëdhënie të plotë pune në kohë të pacaktuar.

Raport financiar për vitin 2012

MJETE	2012	2011
Mjete të përhershme		
Mjete themelore	13.767	13.817
Investime Jomateriale	960	960
Fondi për banim	110.004	7.604
Gjithsej mjete të përhershme	24.731	22.381
Mjete qarkulluese		
Mjete në të holla	6.063	2.043
Avance	2.013	2.145
Kërkesa nga blerësit	2.413	3.459
Kërkesa financiare afatshkurta	79.852	59.212
Kërkesa tjera	12.846	6.169
Gjithsej mjete qarkulluese	103.187	73.027
GJITHSEJ MJETE	127.918	95.408

FONDE DHE OBLIGIME	2012	2011
Obligime afatshkurta		
Obligime ndaj furnizuesve	3.704	444
Obligime tjera afatshkurta	25.725	5.160
Gjithsej obligime afatshkurta	29.429	5.604
Kufizime kohore pasive	928	1.003
Gjithsej kufizime kohore pasive	928	1.003
Të ardhura të pranuar nga vitet paraprake	6.500	3.727
Gjithsej obligime	36.856	10.334
Fonde dhe rezerva		
Fonde	90.602	94.888
Dallime të ardhura/shpenzime në perludhën aktuale	459	-5.083
Gjithsej fonde dhe rezerva	91.062	89.804
GJITHSEJ OBLIGIME DHE FONDE	127.918	95.408

TË ARDHURA	2012	2011
Donacione dhe grante		
Bashkimi Evropian	7.396	7.187
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)	11.622	5.378
Sokotab dhe partnerët, Zvicër	5.739	5.290
OSI Budapest	1.459	3.756
Donatorë tjerë	3.200	852
Gjithsej donacione dhe grante	29.966	25.571
Të ardhura personale		
Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje (MRFP)	10.415	10.727
Org. Për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OBCE)	2.914	1.608
Të ardhura tjera personale	214	4.517
Gjithsej të ardhura personale	14.040	18.100
Kamata dhe dallime pozitive të kursit	3.791	3.736
Të ardhura të jashtëzakonshme	1.328	1.123
GJITHSEJ TË ARDHURA	49.125	48.530

SHPENZIME	2012	2011
Shpenzime bamirëse		
Projekte për modernizimin e arsimit (PMO)	4,608	4,608
Udhëheqja me MRFP	234	186
Forumet në bashkësi (PFZ)	7,240	273
Aftësimi i grave nga rajonet e konfliktit (OZHP)	236	0
Qasja e romëve deri te EU fondet (PRF)	1.603	1.466
Sundimi i drejtë dhe pjesëmarrja (DVP)	2.342	0
SHC e rrënjësor dhe dinamike (VDG)	3.996	0
Gjithsej shpenzime bamirëse	20.668	26.218
Shpenzime operative		
Rroga dhe kompensime për personellin	15.444	17.719
Shpenzime tjera operative	12.141	8.992
Informata dhe publikime	232	544
Gjithsej shpenzime operative	27.816	27.255
GJITHSEJ SHPENZIME	48.484	53.473
BILANCI para tatimit	641	-4.943
Tatimi	-181	-141
BILANCI	459	-5.083

Raport vjetor 2012

Botues

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Adresa e botuesit

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
rr. Nikolla Parapunov 41a, Shkup

F.postar 55, 1060 Shkup
Republika e Maqedonisë

Kontakti

Tel. 02/3065-381

Faksi 02/3065-298

e-posta: mcms@mcms.mk

www.mcms.mk

Bordi i drejtorëve

Aleksandar Kërzhallovski

Dimçe Mitreski

Redaktor përgjegjës

Gonce Jakovleska, MCMS

Përktheu

Gramoz Shabani

Fotografitë

Foto arkivi i MCMS

Dizajni grafik

Boris Ristovski, MCMS



QENDRA MAQEDONASE PËR
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

MCMS

